



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:232610

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05724432

C.nr.464/2018

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 23.05.2024, në GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil në çështjen juridike të paditëses BKS të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Kompania "V S" me përfaqësues F.L sipas autorizimit kundër të paditurit F.N nga fshati M, komuna e V, me objekt kontesti rimbursim dëmi.

P r e z e n t:

Gjyqtari:
Leotrim Gashi

Për paditësen

F.L

Për të paditurin:
F.N

Zyrtare ligjore
Liridona Bajrami

Pyeten palët se a kanë vërejtje në përbërjen e gjykatës:

Pa vërejtje nga palët.

Seanca është publike

Filloj ne ora 10:00.

Gjyqtari i çështjes e hap shqyrtimin mbi këtë çështje, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në këtë seancë prezent është përfaqësuesi i autorizuar e paditëses F.L dhe i padituri F.N

Andaj gjykata konstaton se ka kushte ligjore për mbajtjen e seancës, e si rrjedhojë merr:

A K T V E N D I M

Seanca e sotme mbahet dhe e njëjta është publike.

Gjykata i njofton palët prezente se duhet të mbajnë rendin dhe qetësinë në gjykatë dhe nuk duhet të flasin derisa gjykata të iu jap fjalën, për prishje të rendit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, gjykata mund që duke u bazuar në nenin 289.2 të LPK-së, fillimisht do t'i qortojë palët dhe nëse kjo rezulton të jetë e pasuksesshme mundet që ti largoj nga salla dhe t'iu shqiptojë gjobë deri në 500 euro.

Gjykata i njofton palët së në këtë seancë përgatitore duhet të parashtrojnë të gjitha faktet në të cilat mbështesin kërkesat e tyre si dhe të propozojnë të gjitha provat më të cilat pretendojnë të vërtetojnë faktet e tilla.

Gjykata i njofton palët se kontestin mund ta zgjidhin edhe në procedurën e ndërmjetësimit, në pajtim me nenin 411 të LPK – së si dhe me anë të pajtimit gjyqësor siç parashihet në nenin 412 të LPK – së.

Përfaqësuesi i paditëses lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit deklaroi:

Ne si përfaqësues të BKS jemi të gatshëm që palës së paditur t'i ofrojmë mundësinë që të arrijmë marrëveshje gjyqësore, në të cilën pala do të ketë mundësi që ta paguajë vlerën e kërkuar në padi, në tri këste njëkohësisht heqim dorë nga kamata ligjore ndërkaq vlerës së kërkuar në kërkesëpadi duhet t'i shtohet edhe taksa për padi ne vlerë prej 20 euro.

I padituri F.N lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit deklaron:

Pajtohem që në këtë çështje të arrijmë pajtim gjyqësor, sipas propozimit të palës paditëse që shumën ta paguajë në tri këste.

Palët ndërgjyqëse deklarojnë se kanë arritur pajtim gjyqësor dhe i propozojnë gjykatës që ta aprovojë këtë:

PAJTIM GJYQËSOR

DETYROHET i padituri F.N nga fshati M, komuna e V, që në emër të shkaktimit të dëmit, në aksidentin e datës 10.03.2013, të ia paguajë paditëses shumën prej 135 euro si dhe taksën për padi në vlerë prej 20 euro, dhe atë në tre këste mujore, me nga 51.66 euro, në muaj duke filluar nga data 01 deri 12 të çdo muaji vijues deri në përfundim të përmbushjes totale të detyrimit, e cila shumë duhet të paguhet në xhirollogarinë e paditëses me numër, në bankën private të...

Gjykata në bazë të nenit 411 dhe 412 të LPK –së, merr këtë:

AKTVENDIM

APROVOHET pajtimi gjyqësor, i lartpropozuar nga ana e palëve ndërgjyqëse.

Ky pajtim paraqet titull ekzekutiv dhe mund të goditet vetëm me padi.

Procesverbali pasi u dëgjua me zë i njëjti edhe u nënshkrua pa vërejtje.

Përfundoi në ora 10:30 minuta.

Përfaqësuesi i paditëses

I padituri

V e r t e t o j n ë

Zyrtarja ligjore

Gj y q t a r i
